



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republik of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVËS  
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA

Pranuar - Primitur	16-05-2022		
Nr./ organit Org.broj	Kuam. (titull)	Shprehje Pika	Vlera Vendimet
01-060/01-537			



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

Në mbështetje të nenit 52, paragrafi 52.1 të Ligjit Nr.03/L - 040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 28 / 15, Qershor 2008), dhe të nenit 42, paragrafi 42.3 të Statutit të Komunës së Vitisë, Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, nenin 6, pika 1 e Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Vitisë, Nr.01-013/594, e datës 02.05.2014, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë bënë këtë:

## F T E S Ë

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e **IV** të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa, që do të mbahet me datë **20.05.2022 (e Premte)** në ora 10:00.  
Mbledhja do të mbahet në zyrën e konferencave në objektin e vjetër të Komunës së Vitisë.

Për këtë mbledhje kryesuesi propozon këtë:

### R e n d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e tretë e Komitetit për Politikë dhe Financa.
2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshimin-plotësimin e emrit të shkollës së Mesme Profesionale.
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e ndryshim-plotësimin e Statutit të Komunës së Vitisë Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011.
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e planit të punës se komitetit për Arsim, Kulturë, Rini e Sport për vitin 2022.
5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e shfuqizimit të vendimit për caktimin e lokacionit për varrezat e fsh. Kabash, vendimi me Nr. 01-110/05-365 i datës 04.04.2022, me kërkesën e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor me Nr. 1987-2/22 e datës 29.04.2022.
6. Informatë mbi punën e komiteteve funksionale për periudhën janar-maj 2022.

Viti, më 16.05.2022

Me respekt!  
Kryesuesi i Kuvendit  
Bekim Azizi





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality of Viti/na

## PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E TRETË E KOMITETIT PËR POLITIK DHE FINANCA

Mbledhjen e thirri dhe e kryesoi z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më **20.04.2022 (e Merkurë)** në zyrën e konferencave të objektit e vjetër të Komunës së Vitisë, duke filluar me punë në ora 10 h. Në mbledhje morën pjesë: z.Hasan Aliu (nënkryetar i Komunës), z.Bekim Azizi (kryesues i Kuvendit Komunal), z.Illir Zuka, z.Ramadan Deliu, znj.Zejnepe Osmani, z.Jakup Demiri, znj.Liridona Bislimi, znj.Zyrafete Rama. Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive. Pasi u konstatua se prezent janë 7 anëtarë të KPF-së, andaj kishte kuorum, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

**Kryesuesi z.Bekim Azizi:** Përshëndetje për të gjithë ju anëtarë të KPF-së, drejtorët që janë prezent në këtë mbledhje, mirë se keni ardhur në mbledhjen e tretë të rregullt të KPF-së për këtë vit! Desha të ju njoftoj se shumicën e aktet që i kemi miratuar kanë marr ligjshmërinë nga ana e MAPL-së. A ka dikush jashtë rendit të ditës ju lutem?

**Ilir Zuka:** Përshëndetje për të gjithë! Kam një shqetësim të vogël. Dje kemi pas përvjetorin e dëshmorit Mejdî Korranit. Është hera e parë që kryesuesi i Komunës së Vitisë nuk merr pjesë në homazhe. Ti je përfaqësues i zgjedhur i Kuvendit Komunal të Vitisë.

**Kryesuesi z.Bekim Azizi:** Kam qenë me agjendë dje. Janë pak njerëz në Komunën e Vitisë që janë me të rregullt që 23 vjet në homazhe nivel të Vitisë, në kuadër të asaj për çështjen e koranëve, për 23 vjet, 20 herë. Jam kanë në familjen e tyre me datën 19 në mbremje, por nuk kam pas asnjë ftese sikurse me vijnë në zyre.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim, për këtë mbledhje kemi këtë:

### R e n d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dytë e Komitetit për Politikë dhe Financa.
2. Pasqyrat Financiare të Buxhetit Komunal për periudhën janar-mars 2022.
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2021 në vitin 2022.
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen interes të përgjithshëm për hapjen e rrugës së re në Zonën Kadastrale në Sllatinë.
5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave të ankandit publik për dhënien e pronës së komunës në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë.
6. Informatë për manifestimin tradicional kulturo-sportiv "Flakadani i Karadakut 2022".
7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes akandit publik.

**8. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për formimin e komisionit vlerësuar dhe zbatimin e procedurave për dhënien e pronës paluajtshme të komunës në shfrytëzim**

**9. Propozim për shqyrtimin edhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të ambulantes në fshatin Gushicë të Vitisë.**

**Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Përshëndetje ju anëtarë të KPF-së! Duke pas parasysh procedurat të cilat ne u dashtë të kalojnë në regjistër të pronave komunale, të cilat gjate viti 2022 do ti japim në shfrytëzim. Dhe e dyta, është për përfitimin e donacionit të ambulantes.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** A ka dikush rreth rendit të ditës ju lutëm? Pasi që nuk ka e qes në votim për miratim. Nga të gjithë të pranishmit u miratu rendit i ditës.

Si pikë të parë të rendit të ditës kemi:

**1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dyte e Komitetit për Politikë dhe Financa**

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Pasi që nuk ka vërejtje, qes në votim për miratim. Nga të gjithë u miratu pika e par e rendit të ditës.

Si pikë të dytë të rendit të ditës kemi:

**2. Pasqyrat Financiare të Buxhetit Komunal për periudhën janar-mars 2022.**

**z.Besnik Imeri, drejtor:** Përshëndetje për të gjithë! Do e bej paraqitjen e pasqyrave të Buxhetit Komunal për periudhën janar-mars 2022 në pika te shkurta. Gjate periudhës janar mars 2022 janë gjithsej te hyrat në vlerë për 167 mijë 471 euro e 48 cent, shkalla e inkasimit duke u bazuar në planifikimin është 16,95%, ndërsa krahasuar me të hyrat për periudhën janar-mars 2021. Të hyrat e vitit 2022 janë të ulta për 69 mijë 254 euro e 65 cent. Arsyeja e inkasimit më të ultë është heqja e pagesës së tatimit në pronë. Shpenzimet buxhetore për periudhën janar-mars të këtij viti, të hyrat vetanake dhe donacionet janë 2 milion e 820 mijë 858 euro e 96 cent, ndërsa shpenzimet janë 565 mijë e 721 euro e 73cent. Shkalla e ekzekutimit të buxhetit për periudhën janar-mars 2022 është 90,96% në krahasim për te gjitha programet dhe kategoritë, shpenzimet apo ekzekutimi i buxhetit në kategoritë ekonomike, paga dhe shtesa është 98,61%, mallra dhe shërbime 64,00 %, komunal 14,91%, në kapitale 95,04%. Më tej kemi pasqyrat e ekzekutimit të të gjitha njësive buxhetore. Të hyrat për janar-mars 2022 kanë qenë 232 mijë e 659 euro, te hyrat e realizuara për këtë periudhë janë 167 mijë e 471 euro e 48cent. Shkalla e realizimit, duke u bazuar është 71,98%, të hyrat e planifikuar për viti 2022 janë 987 mijë e 868 euro, shkalla e realizimit, duke u bazuar në planifikim, dhjetor është 16,95%. Te prezantimi i investimit janë paguar obligimet të cilat janë kryer në vitin 2021, por për arsye të programit të ekzekutimit nuk kam mujt me egzekutu, pagesat janë mbulu, fushat sportive, rregullimi i rrugëve me zhavor, rregullimi i lumenjve dhe riparimi në shkolla në vlerë prej 570 mijë e 731 euro e 81cent, nafti qeveritar te investimeve sipas burimeve te financimit për këtë periudhë merr pjesë me 331 mijë e 840 euro e 98 cent ose 89,51% te hyrat vetanake 90,49%.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Kisha hap diskutimin te anëtarët e komitetit në lidhje me raportin e drejtorit.

**Liridona Bislimi, këshilltare:** Përshëndetje për te gjithë anëtarët e komitetit, për drejtorë! Sa i përket pasqyrave financiare të buxhetit komunal për periudhën janar-mars 2021, ne e kemi bërë një analizë të materialit dhe qysh ne fillim kur e shohim tek të hyrat qe i kemi si komunë, vërejmë se në bazë të materialit qe e keni bërë ju në fund e keni cekur, se të hyrat janë me te ulta për 69 mijë euro, po mundona sa me shkurt përkundër faktit qe ka shumë për me analizu që në fillim e përmendi drejtori. Materiali është i detajuar, po ka shumë paqartësi dhe sinqerisht drejtor po ta tregoj, nga praktikat e drejtorit të kalum, që pyetjet që i kemi bërë zakonisht naj ka sjell në kuvend ose përmes imellave zyrtare, po përmes imellave zyrtare nuk është bërë kjo, nuk është praktiku prej juve në mbledhjen e fundit qe e kemi pas, ato pyetjet që i kemi bërë si Lëvizje Vetëvendosje, ke thënë me i dërgu përmes imelles zyrtare. Në momentin qe e bëjmë një pyetje është obligative prej juve qe me e kthy ne seancë atë çka e dëshirojmë. Atëherë te pagesat e vendimeve gjyqësore, është shuma prej 57mijë. Na nevojitet ta dimë sa vendime gjyqësore janë ekzekutua, sa janë në proces, sa është prej buxhetit të komunës deri tash e shpenzume, prej cilave kode buxhetore janë bërë këto pagesa dhe në fund a e keni bërë një llogaritje totale. Tek

shpenzimet e rrymës 59 mijë, na nevojitet ta dimë kostoja e kësaj mbledhja nga është bërë. Tek shpenzimet e telefonisë mobile 5000 mijë. E kemi të pa qartë kjo kostoja kaq e lartë tu marr parasysh se sot për sot shumica e bisedave bëhet përmes telefonave pa shpenzime. Kosto te shërbimet e ndryshe shëndetësore 46 mijë na nevojitet një raport i detajuar, çka janë këto shërbime të ndryshme shëndetësore; dhe tek shërbimet kontraktuese tjerë 18 mijë; dhe te pajisjet tjera, tek furnizimet 23 mijë shpenzimet edhe tek furnizimi me veshmbathje. Kush është furnizu me këtë veshmbathje e keni dërgu tek zjarrfikësit, shëndetësia në shkollë, mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve. Te mirëmbajtja e rrugëve lokale 38 mijë për tremujorin e parë, sidomos në rrugët ku ka pasur vende malore për mosmirëmbajtjen e rrugëve për periudhën janar-shkurt-mars. Te Zyra e Kryetarit, te pjesa e subvencioneve, e kemi akomodimin e pashpenzuar, 16 mij. Te shpenzimet e kemi zero: pse është kjo përqindje kaq e ultë. Te shërbimet kontraktuese tjera, çka është kontraktu prej kryetarit. Te bujqësia dhe zhvillimi rural, është te pjesa e subvencioneve 35 mijë, në fund i kemi ato që është punu zero. Vitia si komunë njihet si komunë bujqësore dhe tremujorshi i parë përdoret për të mbjellat e misrit. Pse nuk është shpenzu aspak buxheti këtë pjesë. Te kultura, rinia dhe sporti, furnizimi me veshmbathje më intereson çka është blerë. Te shpenzimet e drejtorisë arsimit duhet me dite te pagesat për vendimet gjyqësore: a janë pagu mësimdhënësit prej kësaj shume 56 mijë. Te pjesa te të hyrat buxhetore komunale vetanake të planifikume dhe realizuar për periudhën janar-mars. Të hyrat e inspektimit të realizuara janë zero për tremujorshin e parë. Te taksat për legalizimin e objekteve, planifikim zero vjetor, planifikim mujor, zero gjitha janë zero. Pse ka ndodh kjo një shpjegim. Pse nuk aplikohen lejet mjedisore? Te lejet e ndërtimit është përqindja e tremujorit të punës 2,69%. Tek te hyrat nga qiraja dhe objektet shëndetësore zero aktivitet edhe tek shitja e masave drurore e kemi zero. Jemi në muajin janar – shkurt – mars. Shkalla e realizimit në planifikimin vjetor është 16,95%.

**z.Illir Zuka, këshilltar:** Unë vetëm një shqetësim pe ngriti, te grumbullimi i mjeteve për tremujorin e parë. Ne e dimë se është vendimi i qeverisë, nuk është obligativ vërtetimi për regjistrim të automjeteve, po duhet me gjetë një formë. Për tremujorin shumë pak 70 mijë euro, numri është shumë i madh, dhe e dyta te subvencionet, te Drejtoria e Kulturës, se di kur kanë m'i shpërnda ato subvencione, kur klubet në Komunën e Vitisë janë buzë falimentimit, për kur janë tu i ruajt ato subvencione. Nëse falimentojnë klubet, si i bëjnë subvencionet, s'këm arsyeshmëri si e bëjmë, tani raportin financiare me ja dorëzu drejtorive, se po jepen me një kohë që s'mundesh me i hargju.

**z.Jakup Demiri, këshilltar:** Ne Smirë ndriçimi publik dhezet ditën dy here. Informatën e kam pru në kuvend dhe kërkush nuk ka marr asnjë hapë. Është hera e tretë që e potencoj. Besnik, si drejtor i financave, grandet qeveritare, projektet qe i paguan qeveria, ministri përkatës. A ka ndonjë donacion që komuna jonë ka hupë për shkak që s'janë kry punimet. Donacionet nuk mujmë m'i kthy sikur i kthejmë të hyrat vetanake. Du mi ditë: a ka shumë edhe sa janë? Për pjesën e punës qe s'janë kry donacioni humbet.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Është e vërtet se edhe unë i kam marr pasqyrat financiare, i kam analizu me të vitit të kalum. Në këtë tremujor, shqetësimin e kam pas edhe unë te 69 mijë euro qe janë te hyrat vetanake ma të ulta. Prandaj drejtorat e dretorive do ta kenë një takim edhe kem të bëjmë me një ekzekutiv ma të ri, me një përvojë ma të vogël, por gradualisht do të hymë në rrjedha të njëjtit indikator, të cilin mund t'i përdor si ekzekutiv për grumbullimin për të hyrat vetanake do t'i përdorim. Pagesa e evidentimin gjyqësorë, total e përmende 99%, janë mjete te personelit arsimore, për shkak të kontratës kolektive dhe kur e zgjedhim këtë problem, ku gjithë komunat, nuk po fajësoj vetëm Komunën e Vitisë, është mbarë Kosovës. Një prej çështjeve shumë të ndjeshme të cilën e kam ngrit, ka qenë edhe kjo. Pikërisht ngritja e këtyre zërave ka bërë që rrogat, të planifikohet buxheti dhe mos dëmtohet buxheti i komunës. Këto çka janë tu ekzekutu tash përmes gjykatës, përmes kontratës kolektive dëmtohet buxheti i komunës tone. Drejtori obligohet me i pru, sa janë vendime gjyqësore te personelit arsimor dhe te tjera, ndërsa sa janë ne procedurë, Liridon nuk muj me ditë, e dimë vetëm atëherë kur gjykata na fton në përfaqësim. Shërbimet e ndryshme shëndetësore, do ta marr përsipër unë ta sjell; shërbimet kontraktuese tjera, do ta marrësh përgjigjen e njëjtë. Shtyllat te cilat i kemi pasqyrat financiare është një standard, e ka instalu ministria dhe ato të cilët nuk ka emërtim të veçantë tani i qet shërbimet kontraktuese tjera. Furnizimi mjekësor, muj me ti pru dhe çka është bërë dhe furnizim me veshmbathje. Riparimi



i veturave. Kërkush nuk e dinë të veturat e vjetra kur prishen dhe kur jo, nëse dyshon që është keqpërdor diçka, lirisht thuaje. Kem të bëjmë me vetura shumë të vjetra, për shkak mungesës tash në ekzekutiv kem vendos me i marr me qera. Mirëmbajtja e rrugëve, te ti kanë pas vërejtje qytetarët, te unë ka pas lavdata për rrugët qe i kemi mbajt mirë. Shërbimet kontraktuese, drejtorët e drejtorive kanë mëndu për ato, është edhe alokimi i mjeteve me i dhënë 400 fermerëve farë misëri. Te inspektorati jem keq, se naj kanë marr ata të nivelit qendror, na kanë bërë edhe nivel regional. Mos funksionimi i komunës, këtu nuk pajtoj, është një emërtim i paqëndrueshëm, e din se komuna ka punu, mund të ketë vërejtje, por shërbimet qytetarët i kanë kry dhe ata të cilët kanë pas me pagu lirimet ndaj Komunës së Vitisë. Iliri ka ngritë një çështje të subvencioneve dhe kohën e pagesës së klubeve. Ne kem rregulloren e cila ka ardh nga niveli qendror, e aplikojmë këtu. Kem dhe ankesë nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, për mos kthimin e raporteve për mjetet. Se dimë a ka të drejtë me i pas paret në bankë dhe të drejtë me apliku. Gjithherë jem kanë në kuadër mundësive me ju ndihmu ktyne, tash se di sa kanë qenë të mjaftueshme tu bërë përpjekje të gjithëve nga pak por më së shumti klubëve futbollistike “Vëllaznia” dhe “Vitia”. Jakup, e di se sa herë e ki ngrit çështjen e dritave, drejtori i shërbimeve publike nuk është këtu, unë kam konsideru se gjithherë drejtorat të jenë prezent këtu, të bëhen pyetjet direkte, por do ta marr si obligim dhe ti qoj të shoh, cili është defekti nga i cili nuk shuket dhe hargojmë rrymë.

**z.Jakup Demiri, këshilltar:** Vërejtjet i japim si Lëvizje Vetëvendosje. Sa i përket inspektoratit, komuna e Vitisë nuk funksionon. E dimë se në qendër të Vitisë ndërtohen objekte, nuk ka gjoba për hedhje të mbeturinave, Janë dëmtu objektet edhe të banuesve, lejet e ndërtimit se di sa japin, nuk funksionon sa i përket aspektit të inspektoratit.

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Krejt këto të cilat ti i ngrite janë ashtu, por a ka vepru komuna, po, ne kuadër të ligjeve dhe krejt ata kanë lëndë në gjyq. Nuk është që s’htë vepru. Tash a ju ka arrit dhe kur do të arrihet qëllimi kryesor mu pastru prej aty, janë ditët në vijim me legalizu, nuk mundet, janë çështje të cilat do të shkojnë më tutje, dhe a ka pas inspektor të tillë nuk mundem me të thanë se ka pas, për shkak se edhe ata janë kanë në telashe me përjashtime. Ne mund të ngrisim si çështje edhe në kuvend, të lypim detaje për çdo objekt të ndërtuar dhe të shikojmë procedurat a i kanë ndjek me aspekt ligjor.

**z.Jakup Demiri, këshilltar:** Drejtori i inspektionit i ka të garantuar paret. Mundet mi pas të garantume për shkatërrimin e themeleve kur janë ne fillim. Te ju nuk e di a i ka në Prishtinë, e di se i ka e di se kam qenë me një aksion vet, kam qenë prezent. Unë pajtohem me kohë, po e di se si ka funksionu në komunën tone çështja e inspektorëve. Gjoba s’ka pas thuajse kurrë, rroga kanë marr, kanë pas inspektor, detyrën të kryer nuk ka pas.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Pasi që nuk ka për diskutim e qes në votim të shkoj për miratim në kuvend. Konstatoj se me vota unanime shkon për kuvend.

Si pikë të tretë të rendit të ditës kemi:

### **3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2021 në vitin 2022**

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Tashmë kjo është një praktikë që të hyrat vetanake duhen të barten te cilat kanë mbet në drejtori dhe në bazë të përvojave qe kemi pas, ne e dimë që këto të hyra vetanake shkojnë në kode të njëjta buxhetore, ku kanë deponu, ku të mos bëhet ndryshim.

**z.Besnik Imeri, drejtor:** Duke u bazuar në Ligjin Nr.08/L-066, ne dalje buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, neni 9, ndarje dhe rindarje dhe të bartura si dhe obligimet e faktuarve financiare nga viti paraprak. Pika 1.2, bilancet e pashpenzuara te të hyrave vetanake të komunave për bartjen e buxhetit komunal në vlerë prej 682 mijë e 49 euro e 68 cent të viti 2021 ne vitin 2022. Bartja e buxhetit komunal nga të hyrat vetanake komuanle propozohen të shpërndahen në këto kategori ekonomike, mallra dhe shërbime në shumë prej 176 mijë e 24 euro e 21 cent apo 25,78%; subvencione 162 mijë e 48 euro e 68 cent ose 23.73%; investime kapitale në shumë prej 344 mijë e 776 euro e 79 cent apo në përqindje 50.49%. Të shpërndara në programet buxhetore i kemi të detajuara më poshtë.

**znj.Liridona Bislimi, këshilltare:** Drejtor, tek buxhetimi, te pika e parë, rregullimi i kanalizimit, kodi 4, 1, 5, 9, 7 na nevojitet me ditë cilat kanalizime në cilat fshatra bëhet fjalë. Tek e pesta, rregullimi i rrugëve me zhavorr, kodi 4,1,600, cilat rrugë bujqësore kanë me u shtru. Tek shërbimet e shëndetësisë primare, tek pika 1, renovimi i ambulanteve, kodi 4, 1, 6, 1, 4, cilat ambulanta. Dhe tek e dyta, furnizimi me aparaturat e digjitalizim. Parimisht na që kem përvojë, këto janë paret që kanë tepru vitin e kalum. Ajo çka nuk është shpenzu, duhet me bartë për vitin 2022, asnjë cent, me ndërru kodin e buxhetit, edhe nëse ka tepru qysh është kanë e parapamë. Ju e dini se mundem me shiku në rishikim në Qershor, mbas 6 muajve. Kjo është pjesa e pare qe duhet bartet kodi qe ka qenë.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Pasi që nuk ka për diskutim, e qes në votim të shkoj për miratim në kuvend. Konstatoj se me vota unanime shkon për kuvend.

Si pikë të katër të rendit të ditës kemi:

#### **4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen interes të përgjithshëm për hapjen e rrugës së re në Zonën Kadastrale në Sllatinë**

**z.Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Anëtarë të KPF-së, kem të bëjmë me rrugën Viti-Sllatinë. Përmes komunitetit të Sllatinës, iniciativa e tyre ka qenë, fillimisht do t'i lirojnë pronat gjitha. Veç ta caktojmë këtë pjesë, sepse rruga kur të bëhet ma funksionale dhe pas shpalljeve të zgjedhjeve të cilat janë shpall vitin e kalum, kam qen nja dy tre takime, të cilat pjesa dërmues te ktyne kanë thanë se të gjitha pronat çka është prej ari nuk do te lypin kompensim. Janë dy persona të cilët i kanë diku nga 2, 3 ari, por ajo qe është me rendësi e dëmton shumë, se është e hollë dhe hyrja e 8 ari e bënë jofunksionale. Ka pas edhe propozime edhe për rregullim te kthyer në formë tjetër me humb nga pak disa kanë pranue. Heqja e procedurës në atë kohë nuk na u ka leju. Unë kam arrit mos me humb donacionin, me bërë një marrëveshje së bashku me ata që pas zgjedhjeve me obligu, por me obligu komunën qe pas zgjedhjeve me udhëheq procedurën. Prandaj pyetjen kujtoj që e bëri këshilltarja në kuvend, Lindita Demelezi. Pikërisht kjo dhe ne momentin e parë kam thënë që na krijohet mundësia, bëhet kuvendi jo funksional, do të shpalli në interes të përgjithshëm dhe për personat në fjalë do të zhvillohen procedurat e shpronësimit.

**znj.Majlinda Ostergllava, drejtoreshë:** Në kuvendin tjetër kur te jemi gati për shpronësim do te vjen propozim vendimi për shpronësim.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Pasi që nuk ka për diskutim e qes në votim të shkoj për miratim në kuvend. Konstatoj se me vota unanime shkon për kuvend.

Si pikë të peste të rendit të ditës kemi:

#### **5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave të ankandit publik për dhënien e pronës së komunës në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë**

**znj.Majlinda Ostergllava, drejtoreshë:** Është me mandatë dyvjeçar për ankande të ankesave. Të gjitha ankesat janë dyvjeçare.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Pra, për të gjitha ankandet, për gjitha pronat qe jepen ne shfrytëzim janë me mandat dy vjet.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Pasi që nuk ka për diskutim e qes në votim të shkoj për miratim në kuvend. Konstatoj se me vota unanime shkon për kuvend.

Si pikë të gjashte të rendit të ditës kemi:

#### **6. Informatë për manifestimin tradicional kulturo-sportiv “Flakadani i Karadakut 2022”**

**z.Ismet Sejdiu:** Të nderuar te pranishëm, në emër te drejtorit te drejtorisë ju përshëndes me rastin e këtij takimi te Komitetit për Politikë e Financa, ku ne mes pikave tjera është për manifestimin tradicional kulturor – sportiv te Flakadani i Karadakut. Ashtu si herëve tjera do te thotë ne bëjmë grupin koordinues për organizimin

e këtij manifestimi tradicional në komunën tonë dhe ashtu siç e keni informatën të gjithë anëtarët, keni edhe emrat e natarëve të fushës koordinuese me drejtorin koordinator Valmir Sahiti. Fillimisht ju njoftoj se këtë vit ka qenë edicioni i 20 me rradhë të manifestimit tradicional kulturor-sportiv, manifestim ky i cili në vete ngërthen raste të shumta kulturore –sportive. Në kemi bërë hapjen me 21 Mars, ku kanë marr pjesë mysafir të shumtë, Sipas programit dhe skenarit kemi pas programin folor dhe pjesën artistike, ku kanë marr pjesë artist edhe nga estrada e Kosovës. Aktiviteti i dytë i radhës ka filluar me 22 Mars në gara regjionale të recituesve, ku gjitha komunat i kanë pas ftesat dhe prezencën e tyre ka qenë e kënaqshme, duke ditë se edhe viteve të tjera, dy vitet e kalimeve kemi qenë në fushën e kulturës dhe sportit kemi qenë të hendikepuar pak sa të pandemisë Covid 19, por megjithatë kemi arritur që të gjitha aktivitetet t'i kryen sipas planit të paraparë me program dhe skenar të gjithë manifestimit. Zakonisht në për komunat pjesëmarrëse aplikojmë jurinë për vlerësimin e nxënësve me pozitë të tyre dhe zakonisht çdo profesor i gjuhës është njëherë edhe anëtarë i komisionit vlerësues dhe në këtë rast kemi jurinë e përbërë prej këtyre komunave dhe vendin e parë e merr Violeta Kastrati nga Kamenica, vendin e dytë e merr Irina Ahmeti nga “Kuvendi i Lezhës” në Viti dhe vendin e tretë, Suela Dishit nga Kaçaniku. Meqenëse ka qenë vite jubilarë dhe akademitë përkujtimore i kemi të shënuar se kush ka marr pjesë edhe prej grupeve artistike. Në radhë ka qenë edhe turniri në futboll të vogël, gara sportive në shah, gara sportive të pingpong. Buxheti për akomodim 1860 euro për grupet artistike të cilët kanë marr pjesë, akomodimin e kemi bërë të “Nena Naile”, shërbimet gjithsej për këtë manifestim i kemi 495 euro, dreka për grupet artistike sportive janë 7734 euro. Po ashtu për fanella sportive, kupat, diploma e tjera janë 14 mijë 36 euro si dhe shtypja e materialit grafiti, katalog, ndezja e flamujve, postera, fotografi e tjera janë 2885.5 prezantim gjithsej total manifestimi i këtij viti kushton 14 mijë 410 euro, kurse krahasuar me vitin 2019, “Flakadani i Karadakut” ka pas kosto 18 mijë 50 euro, kurse këtë vit e kemi përmbyll me 14 mijë 36 euro gjithsej.

**z. Ilir Zuka, këshilltar:** Më ka shqetësuar ky “Flakadani i Karadakut”, në hapje kanë marr pjesë 110 vet. A e keni menduar se për çka është ky problem? Prej 24 familjeve të dëshmorëve, nuk ka marr pjesë asnjë njeri. Ja vlen me diskutu, do ta diskutoj edhe në kuvend, qaq shumë jeni tu marr me “Flakadani i Karadakut”, i kemi lan anash 23 familje dëshmorëve. A është në rregull kjo? Krenoheni i kemi harxhu 14 mijë euro. Të shohim sa do t'i harxhojmë me 5 Maj, që është Dita e Dëshmorëve, ku janë 24 familje të varrezat e dëshmorëve.

**z. Jakup Demiri, këshilltar:** Po me vjen mirë kjo çka e tha Iliri, Sa hera e parë që nuk marrin pjesë familjet tjera, kjo është ajo që nuk po kemi guxim ne, sepse duhet me thirr shoqatën e veteranëve të luftës, familjet e dëshmoreve edhe duhet me u ulë me bë një zgjidhje për këtë. E di që është e vështirë, kjo punë është e ndjeshme. Unë jam me e përfaqësua LVV e me mbajt disa takime e me bë bashkë një festë për të gjithë dëshmorët, pse mos me bë 5 majin.

**z. Ramadan Deliu:** Pse me qen kaq 5 ditë, pse jo një ose dy ditë.

**z. Bekim Aziz, kryesuesi i komitetit:** Kemi diskutu edhe me herët. Një duhet me ditë, në jemi institucion, “Flakadani i Karadakut” është manifestim i miratuar prej kuvendit komunal dhe kanë obligim drejtoria me e mbajt, e kemi me vendim të kuvendit që këta janë të obliguar me e mbajt. Drejtoria e ka zbatu vendimin e kuvendit, përderisa nuk ndryshon vendimi, këta duhet me e mbajt.

**z. Hasan Aliu, nënkryetar i komunës:** Unë kame pas marr një iniciativë të tillë, të cilën nuk kam pas mujt me kry edhe e kame qu një nga familjet e dëshmorëve që ma ka marr mendja që e ka mirëkuptimin edhe ai ka has në vështirësi dhe me ka than nënkryetar leje këtë punë se nuk bëhet edhe jo rastësisht dikun para dy javë në zyre time i kame thanë disa e tash është koha ku bëhet ndryshimi i statutit. Statuti, janë të parapamë edhe datat shtetërore dhe ato komunale dhe aty është “Flakadani i Karadakut”, “2 Korriku” dhe të tjera. Prandaj tash duhet me u dhënë kontributi kurrsesi me pas përçarje po me mujt me gjet një mes për të gjithë,

**z. Ilir Zuka:** Unë mendoj që me këtë jemi tu i prek shumë 23 familje tjera. Unë kam pas takime me shumicën nga këta e të cilët nuk janë kanë të pranishëm në hapjen e flakadani, e për mu me i hargju këto para e nuk marrin pjesë as 40 vetë, mendoj që duhet me ndryshu këtu. Unë si administrator i Pozharanit kam bë dy javë kërkesë në institucione komunale të Vitisë, sepse besoj që edhe për dëshmorin e Pozharanit i takon me bë një organizim. Nuk kemi mujt me marr asnjë cent që janë shku në Koshare edhe nuk kemi mujt me organizu asgjë në Pozharan.



**znj.Liridona Bislimi:** Pajtohem me këtë çka e tha Iliri, po edhe nënkryetari duhet sinqerisht me marr hapa në këtë drejtim, që duhet të bëhet një ndryshim.

**z.Sejdi Emini:** Jam nga fillimi i këtij manifestimit, e ku ky manifestim njihet si manifestimi më i madhi nga të gjitha troje shqiptare, këtë e thonj të tjerët jo unë. Ashtu siç u cek nga parafolësit është temë senzitive, është zyrtarizu në vitin 2011 “Flakadaku i Karadaku”, po ashtu edhe shoqëria kulturo artistike “Kemajl Azizi”, dyjat janë zyrtarizu edhe e dimë mënyrën se si ka ardh deri tek zyrtarizimi. Kjo çështje është më tepër e faktorit moral e tani politik për me e rregullu këtë çështje duhet këto dy faktor.

**z.Bekim Azizi:** Ju kërkoj që te kjo temë të jemi të kujdesshëm, sepse është temë e rënd për me ndryshu këtë, po duhet me shku në mënyrë institucionale. Ne e kemi vendimin e kuvendit e duhet me punu bazë vendimit te kuvendit.

**z.Illir Zuka:** Unë e ngrita si shqetësim këtë, sepse me keqkuptoj Ismeti. Unë nuk jam për mos me mbajt Flakadanin, po e ngrita si shqetësim.

**z.Jakup Demiri:** Ismeti tha pajtohem me Beken e me nënkryetarin, e me çka nuk pajtohesh me mu. Unë jam shumë i afër me familjen e tyre, po unë e thamë me përgjegjësi të plotë, që duhet me bë ndryshim, jo me hekë krejt, po plotësu këtë.

**z.Bekim Azizi, kryesues:** A jeni që edhe kjo pikë të shkon në kuvend. Me votat e të gjithëve shkon edhe kjo pikë për kuvend.

Si pikë të shtat të rendit të ditës kemi:

**7. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit paraparak për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale përmes ankandit publik**

**znj.Majlinda Ostergllava, drejtoreshë:** Kjo ka të bëjë me barnatoren që është tek objekti i ambulantes, i ka dal afati kontratës, e kemi në listë për dhënien në shfrytëzim. Kërkoj miratimin e kësaj pike.

**z.Bekim Azizi, kryesues:** Hapi debat për këtë pikë. Pasi që nuk ka për debat e qes ne votim për miratim. Me votat e të gjithëve shkon për kuvend edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të tetë të rendit të ditës kemi:

**8. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për formimin e komisionit vlerësues dhe zbatimin e procedurave për dhënien e pronës paluajtshme të komunës ne shfrytëzim**

Ky komision formohet për vlerësimin e pikës së shtatë. A jeni që të miratohet edhe kjo pikë e rendit të ditës. Me votat e të gjithëve miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të tetë të rendit të ditës kemi:

**9. Propozim për shqyrtimin edhe miratimin e propozim vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të ambulantes në fshatin Gushicë në Viti**

**znj.Majlinda Ostergllava, drejtoreshë:** Me kërkesën e drejtoreshës së QKMF-së, ku është një donacion, e kemi pas kërkesë për caktimin e lokacionin. Kërkojnë miratimin e juaj.

**z.Bekim Azizi, kryesues:** Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Pëlqimin e Drejtorisë së Urbanizmit e keni.

**z.Jakup Demiri:** Ne e kemi një problem në Smirë, pikërisht me ambulanten aty, që edhe në atë kohë nuk është bë bartja e parcelës, e ku sot e shfrytëzon dikush tjetër.

**z.Bekim Azizi, kryesues:** Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim, e qes ne votim për miratim. Nga të gjithë u miratu edhe kjo pikë e rendit të ditës. Faleminderit për kontributin e dhënë, shihemi në seancën e kuvendit. Ju falënderoj për kontributin e dhënë në këtë mbledhje të KPF-së.

Me kaq shpall të mbyllur këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në ora 11:30

**Procesmbajtësi:**

**Fatlum Demiri**

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal:**


**Bekim Azizi**





Republika e Kosovës  
Republik of Kosova  
Republika Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA			
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA			
Pranuar - Pritur	17-05-2022		
Nr. i organit Org. broj	Komunë/ Broj	Shitje/ Pritje	Vlera/ Vlerësim
02-035/02-573			



Komuna e Vitisë  
Municipality of Vitina  
Opština Vitina

Në pajtim me dispozitat e nenit 13 dhe 58.1 të Ligjit nr.03/L-040,për vetëqeverisjen lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës),Statuti i Komunës së Vitisë nr.01-013/491 neni 35.1,35.2 pika (a), dhe Ligjit mbi Arsimin në Komunitat e Republikës së Kosovës nr.03/L-068,Ligjit për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës nr.04/L-032 neni 13,udhëzimi administrative i MASH-it nr10/2008 neni 2,3.Drejtorja e Arsimit miraton këtë:

### PROPOZIM VENDIM

#### PËR NDRYSHIMIN-PLOTËSIMIN E EMRIT TË SHKOLLËS SË MESME PROFESIONALE

##### I.

Me këtë Propozim-Vendim,Drejtorja e Arsimit të Komunës së Vitisë,propozon që Shkolla e Mesme Profesionale tash e tutje,në vend të emrimit të tashëm Shkolla e Mesme Profesionale (SHMP) „Jonuz Zejnullahu”në Viti, tani e tutje të emërtohet **Shkolla e Mesme e Lartë Profesionale (SHMLP)** „Jonuz Zejnullahu”në Viti.

##### II.

Këtë propozim-vendim, Drejtorja e arsimit e Komunës së Vitisë e bënë duke u bazuar në Rekomandimin e Divizionit për Arsim dhe Aftësim Profesional (DAAP),në kuadër të MASH-it,ku kërkohet që formulari i institucioneve arsimore të shkollave Divizionit për Arsim dhe Aftësim Profesional (DAAP),në kuadër të MASH-it Divizionit për Arsim dhe Aftësim Profesional (DAAP),në kuadër të MASH-it profesionale,duhet të jetë i njëjtë në nivel vendi si shkollë e Mesme e lartë Profesionale.

##### III.

Poashtu Divizioni për Arsim dhe Aftësim Profesional (DAAP),në kuadër të MASH-it,ka Rekomanduar që ky Riemertim të procedohet përmes Kuvendit Komunal.

##### IV.

Ky Propozim-Vendim hynë në fuqi,pasë miratimit, nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Viti,Maj 2022

Kryetari i Komunës së Vitisë  
Sokol Haliti



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLICA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA

Pratdor: Prishtina Mërdona		16-05-2022	
Nr. i origjinalit Broj. broj	Nr. i kopimit Broj. broj	Shifra e Përllog	Vlera Udhëheq
01-110/04-531			



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality Viti/na

## STATUTI

Për

**Ndryshim plotësimi i Statutit të Komunës së Vitisë, me Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011**

**Maj 2022**

Në mbështetje të Vendimit Nr. 01-110/05-219, të datës 01.03.2022 për miratimin e iniciativës së kryetarit të Komunës së Vitisë për ndryshim dhe plotësim të Statutit të Komunës së Vitisë, në mbështetje të Vendimit Nr.01-110/05-218, të datës 01.03.2022 për emërtimin e komisioni për përgatitjen e ndryshim plotësimi të Statutit të Komunës së Vitisë me Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011, Komisioni rekomandon këto ndryshim plotësime.

## **S T A T U T I**

### **Për ndryshim plotësimi i Statutit të Komunës së Vitisë, me Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011**

#### **Neni 1**

Neni 13, paragrafi 13.3 të statutit bazë, riformulohet si ne vijim: kandidatët për pozita të anëtarëve të këshillit lokal apo kryetarëve të këshillave lokal nuk mund të kandidohen nëse janë të zgjedhur/emëruar në poste udhëheqëse në strukturat e subjekteve/partive politike.

#### **Neni 2**

Neni 28, paragrafi 28.2 të statutit bazë, riformulohet si në vijim: mbledhja inauguruese e Kuvendit të Komunës thirret nga kryetari (aty ku është zgjedhur) brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve.

Neni 28, paragrafi 28.3 të statutit bazë riformulohet si në vijim:

Nëse kryetari i Komunës nuk e thërret mbledhjen sipas paragrafin 28.2 të këtij neni, mbledhja inauguruese thirret nga anëtari më i vjetër i zgjedhur i Kuvendit të Komunës, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data kur kryetari është dashur ta thërras mbledhjen inauguruese të Kuvendit të Komunës.

#### **Neni 3**

Neni 30, paragrafi 30.3 të statutit bazë i shtohet shkronjat d, seancë urgjente dhe seanca inauguruese.

#### **Neni 4**

Neni 32 i statutit bazë, shtohet neni i ri 32 A me tekstin si në vijim: 1. Mbledhja urgjente thirret ne raste të fatkeqësive natyrore apo rrethanave tjera urgjente në komunë dhe 2. Procedurat e thirrje se mbledhjeve urgjente nuk zbatohen si në rastin e thirrjeve te mbledhjeve tjera.

#### **Neni 5**

Neni 47, paragrafi 47.2, shkronja e) të statutit bazë: Tek shkronja e) Komitetit për Mundësi të Barabarta dhe Barazi Gjinore, riformulohet dhe ka këtë përmbajtje: e) Komiteti për Liritë, të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore. Dhe tek shkronja h) Komiteti për Zhvillim Rural, riformulohet dhe ka këtë përmbajtje h) Komiteti për Bujqësi dhe Zhvillim Rural.

#### **Neni 6**

Neni 56, paragrafi 56.1 të statutit bazën, nënparagrafi 2, riformulohet si ne vijim:

2.a. Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe

b. Drejtoria për Zhvillim Ekonomik

#### **Neni 7**

Neni 62, paragrafi 62.1 të statutit bazë, togfjalëshi: "Drejtori i Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim"; riformulohet: Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa.

#### **Neni 8**

Neni 64, paragrafi 64.1 të statuti bazë, togfjalëshi: "Drejtori i Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim" riformulohet: drejtori Drejtorisë për Buxhet dhe Financa.

#### **Neni 9**

Neni 65, paragrafi 65.1 të statutit bazë: togfjalëshi i Ligjit për Shërbimin Civil Nr. 03/L-149, i paraparë në të gjitha nenet e statutit bazë, ndryshohet dhe do të jete Ligji për Zyrtarë Publik Nr. 06/L-114.



#### **Neni 10**

Neni 68 paragrafi 68.1 të statutit bazë: riformulohet si ne vijim: Me qëllim të planifikimit, administrimit, punësimit të zyrtarëve publik në përputhje me neni 14 të Ligjit për Zyrtarë Publik Nr. 06/L-114, Komuna e Vitisë themelon Njësinë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore.

#### **Neni 11**

Neni 69 paragrafi 69.1 dhe në nenet pasuese të statuti baze ku cekët: Njësia e personelit dhe Udhëheqësi i personelit, duhet te zëvendësohet me Njësinë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore dhe Udhëheqësin e Njësinë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore.

#### **Neni 12**

Neni 69 paragrafi 69.3 të statutit bazë: riformulohet si ne vijim: Udhëheqësin i Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore rekrutohet nga kandidatet e nëpunësve civil të nivelit udhëheqës me përvojë 5 vjeçare dhe kualifikim superior nga fusha përkatëse e drejtësisë.

#### **Neni 13**

Neni 70 paragrafi 70.2 të statutit bazë: riformulohet si ne vijim: Në bashkëpunim dhe konsultim me kryetarin e Komunës dhe sipas planit vjetor dhe afatmesëm të personelit përgatit, menagjon dhe publikon konkurset, në përputhje nenin 15,16,17 të Ligji për Zyrtarë Publik Nr. 06/L-114.

#### **Neni 14**

Neni 74, paragrafi 74.1 të statutit bazë: shkronjë a riformulohet si në vijim:  
a- Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore.

#### **Neni 15**

Neni 74, paragrafi 74.1 shkronja g të statutit bazë riformulohet si në vijim:

g) Zyra për Komunikim me Publikun.

#### **Neni 16**

Neni 74, paragrafi 74.1 të statutit bazë: shtohet edhe një shkronjë L me emërtimin:

L - Sektori për Punë të Kuvendit Komunal të Vitisë.

#### **Neni 17**

Neni 74, paragrafi 74.2 të statutit bazë: fshihet nga statuti bazë dhe paragrafi 74.3 i statutit bazë merr paragrafin 74.2.

#### **Neni 18**

Me hyrjen në fuqi të këtij ndryshim plotësimi të statutit, të gjitha aktet nënligjore të komunës do të harmonizohen brenda gjatë (6) muajve.

#### **Neni 19**

Pas miratimit për ndryshimin dhe plotësimin e statutit të Komunës së Vitisë, pushojnë të vlejshme dhe shfuqizohen dispozitat e ndryshuara dhe të plotësuara të statutit Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011.

#### **Neni 20**

Ndryshimet dhe plotësimet në statut hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8 lidhur me neni 9 të Rregullores Nr.10/2019 për procedurat e hartimi dhe publikimi të akteve të komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

**Fatlum Demiri**  
Kryetar i komisionit për ndryshim- plotësim të statutit



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality Viti/na

**Statutit i Komunës së Vitisë, me Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011  
(nenet bazë të statutit e të cilët propozohen për ndryshim-plotësim)**

**Maj 2022**

**Statutit i Komunës së Vitisë, me Nr. 01-013/491, të datës 21.04.2011**  
**( nenet bazë të statutit e të cilët propozohen për ndryshim-plotësim)**

**Neni 1**

Neni 13 paragrafi 13.3 i statutit bazë: Gjatë themelimit ( zgjedhjes) së këshillave të fshatrave dhe të këshillit të qytetit të Vitisë dhe emërimit të kryetarve të këtyre këshillave, duhet respektuar përfaqsimin proporcional të subjekteve politike, në përbërjen e këtyre këshillave dhe në kryesimin e tyre.

**Neni 2**

Neni 28, paragrafi 28.2 të statutit bazë: Mbledhja e parë inauguruese e Kuvendit të Komunës thirret nga kryesuesi i përbërjes paraprake të Kuvendit të Komunës në afatin si nga par.1. i këtij neni.

Neni 28, paragrafi 28.3 të statutit bazë Nëse Kryesuesi nuk e thërret mbledhjen sipas detyres zyrtare si në par.2.të këtij neni, mbledhja konstituive mund të thirret nga antari më i vjetër i zgjedhur i Kuvendit Komunal mbrenda afatit prej 15 ditësh, nga data kur kryesuesi nga par.2. i këtij neni është dashur të thërras mbledhjen inauguruese.

**Neni3**

Neni 30, paragrafi 30.3 të statutit bazë i shtohet shkronjat d, seancë urgjente dhe e, seanca inauguruese.

**Neni 4**

Neni 32 i statutit bazë, shtohet neni i ri 32 A me tekstin si në vijim: 1. Mbledhja urgjente thirret ne raste të fatkeqësive natyrore apo rrethanave tjera urgjente në komunë dhe 2. Procedurat e thirrje se mbledhjeve urgjente nuk zbatohen si në rastin e thirrjeve te mbledhjeve tjera.

**Neni 5**

Neni 47, paragrafi 47.2 të statutit bazë shkronja e- Komitetin për mundësi të barabarta dhe barazi gjinore. h- Komitetin për zhvillimin e Rural.

**Neni 6**

Neni 56, paragrafi 56.1 të statutit bazën nënparagrafi 2: Drejtoria për Financa, ekonomi dhe zhvillim;

**Neni 7**

Neni 62, paragrafi 62.1 të statutit bazë, Të gjitha qështjet që lidhen me administrimin financiar të Komunës së Vitisë ,udhëhiqen dhe janë përgjegjësi e Kryetarit të komunës ,të cilat përgjegjësi kryetari mundë ti bartë me autorizim te nënkryetari I komunës dhe te drejtori I drejtorisë për financa ekonomi dhe zhvillim.

**Neni 8**

Neni 64, paragrafi 64.1 të statuti bazë, Drejtori i drejtoris për financa ,ekonomi dhe zhvillim duhet në qdo kohë ti afroj informacione kryetarit të komunës për gjendjen financiare buxhetore ,për të gjitha kategorit dhe njësit buxhetore të Komunës .



#### **Neni 9**

Neni 65, paragrafi 65.1 të statutit bazë: Shërbimi civil Komunal në Komunën e Vitisë përfshin të gjithë personat e punësuar nga autoriteti Komunal ,pagat e të cilëve paguhen nga buxheti I Republikës së Kosovës ,dhe sipas Ligjit në fuqi për Shërbimin civil të Republikës së Kosovës ( Nr 03/L-149) kanë statusin e nëpunësve civil dhe janë pjesë e shërbimit civil të Kosovës .

#### **Neni 10**

Neni 68, paragrafi 68.1 të statuti bazë: Me qëllim të planifikimit ,administrimit dhe mbikqyrjes së strukturave të shërbimit civil Komunal të administrates komunale dhe përmbushjes së detyrimeve dhe kërkesave nga neni 7.të LSHC. Të Republikës së Kosovës lidhur me nenin 10.par.2.shkronja f të këtij statuti – konstituohet-Njësia për menagjimin dhe zhvillimin e personelit dhe të burimeve njerzore të shërbimit civil komunal –NJËSIA E PERSONELIT.

#### **Neni 11**

Neni 69, paragrafi 69.1 të statuti bazë: Njësia e personelit e shërbimit civil komunal, ka udhëheqësin e personelit.

#### **Neni 12**

Neni 69, paragrafi 69.3 të statuti bazë: Udhëheqësi i personelit regrutohet nga kandidatët shërbyes civil të karrierës me përvojë mbi 3 vjeqare dhe kualifikim profesional superior në fushat përkatëse të drejtësis dhe me konkurs publik.

#### **Neni 13**

Neni 70, paragrafi 70.2 të statuti bazë: Në bashkpunim dhe konsultim permanent me kryetarin e Komunës dhe sipas kërkesave të arsyetuara të drejtorive të administrates komunale harton dhe publikon konkurset për plotsimin e vendeve të lira të punës për shërbyesit civil.

#### **Neni 14**

Neni 74, paragrafi 74.1 të statuti bazë: a-Njësia e personelit të shërbimit civil Komunal.

#### **Neni 15**

Neni 74, paragrafi 74.1 të statuti bazë shkronja g-Zyra për marëdhënie me publikun

Neni 74 paragrafi 74.1 të statutit bazë: shtohet edhe një shkronjë L me emërtimin  
L - Sektori për Punë të Kuvendit Komunal të Vitisë.

#### **Neni 16**

Neni 74, paragrafi 74.2 të statuti bazë Kryetari i Komunës në mbështetje të nenit 50 par.1 shkronja s të këtij statuti, themelon sektorin për demokratizim në kuadrin e përgjegjësisve të të cilit do të jenë koordinimi, menagjimi dhe përgjegjësitë për zyrat dhe njësit nga par.1.shkronja c,g,h i dhe k, të këtij neni.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Prisur - Prindëro Më/Dana 11-05-2022			
Nr. i organit Org. broj	Numri/Broj	Shtojcë Prilog	Vlera Vrednost
01-035/02-506			



Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 40, paragrafi 2, pika d të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 35, paragrafi 2, pika d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Vitisë, paraqet këtë:

**PROPOZIM VENDIM**  
**PËR APROVIMIN E PLANIT TË PUNËS TË KOMITETIT PËR ARSIM, KULTURË, RINI**  
**DHE SPORT PËR VITIN 2022**

**Neni I**

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Vitisë, i PROPOZON Kuvendit, që ta shqyrtoj dhe aprovoj Planin e Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport për vitin 2022

**Neni II**

Pjesë përbërëse e këtij propozim vendimi është Plani e Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport për vitin 2022. Me Nr te protokollit 01-402/02-475 e datës:04.05.2022.

**Neni III**

Për zbatimin e këtij propozim vendimi do të kujdeset kryesuesi i Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport për vitin 2022.

**Neni IV**

Ky propozim vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

KRYESUESI I KUVENDIT

Bekim Azizi





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Prindëtorja Më/Donor				04-05-2022		Vitet	
Nr./ organizatë Org. broj	Namni/Emri	Shtëpisë Prilog	Vlera Vlerësim				
01-402/02-478							



Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality of Viti/na

# Plani i punës dhe aktivitetet e Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport për vitin 2022

VITI, MAJ 2022



Komuna si njësi themelore e vetëqeverisjes lokale në Kosovë, e përbërë nga qytetarët e komuniteteve në një territor të caktuar, duke u bazuar në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040, Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës/ Prishtinë: Viti III / Nr. 28 / 04 Qershor 2008. Në bazë të LVL, Neni 51, paragrafi 51.2, Kuvendi i komunës themelon edhe komitete të tjera të cilat konsiderohen se janë të nevojshme për kryerjen e përgjegjësisive të tyre.

Me këtë dokument do të njoftoheni më hollësisht me punën e Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport.

Ky komitet joobligativ i formuar në kuadër të Kuvendit të komunës së Vitisë, duke pasqyruar një gjithë përfshirje të anëtarëve të Kuvendit komunal 4 anëtarë të Kuvendit komunal dhe një nga shoqëria civile.

- z. Musli Neziri – Kryesues i komitetit, anëtarë i Kuvendit komunal
- z. Ali Bajrami – Anëtarë i komitetit, anëtarë i Kuvendit komunal
- znj. Majlinda Shabani – Anëtare e komitetit, anëtare e Kuvendit komunal
- z. Sokol Hyseni – Anëtarë i komitetit, anëtarë i Kuvendit komunal
- znj. Lirie Ibrahimimi – Anëtare e komitetit, nga shoqëria civile

Prandaj pasi që Arsimi është një fushë mjaftë e rëndësishme për shoqërinë dhe komunitetin tonë në fokus të veçantë procesi edukativo-arsimor, po ashtu e rëndësishme është edhe fusha për Kulturë, Rini dhe Sport.

Ky komitet është përgjegjës për fushat që kanë të bëjnë me edukimin duke filluar nga parashkollor, kopshtet e fëmijëve, arsimin fillor, të mesëm të ulët, të mesëm të lartë dhe fushën për Kulturë, Rini dhe Sport.

Prandaj ne si komitet edhe pse në detyrat që përshkruhen do të mundohemi të japim rekomandime, sugjerime, vërejtjet tona në lidhje me përgjegjësit që n'a takojnë pranë KK të Vitisë, por shpresojmë që këto rekomandime do i marrin edhe Drejtoritë përkatëse (DKA, DKRS).

Për të pasur më të qartë kompetencat e komiteteve konsultative do të i ndajmë në dy fusha të ndryshme detyrat që mund të i kemi ne si Komitet për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport si më poshtë:

## ARSIMI

1. Ndhmon drejtorinë e Arsimit në hartimin e rregulloreve komunale, në pajtim me ligjet në fuqi për arsimin para fillor, fillor dhe të mesëm.
2. Ofron bashkëpunim për drejtorinë e Arsimit në përpilimin e planit zhvillimor, rreth vizionit të shkollave.
3. Promovimi dhe afirmimi për të drejtën e barabartë për Arsim Parauniversitar.
4. Mundësi konsultimi mbi zgjedhjen e kuadrit profesional të mësimdhënësve.
5. Shqyrton ankesat dhe propozimet e nxënësve në lidhje me cilësinë e mësimin dhe masat disiplinore.
6. Kujdesi ndaj resurseve shkollore.
7. Promovimi i vlerave edukative dhe rritjes së dëshirës për mësim-nxënie dhe mësimdhënie.
8. Ofron bashkëpunimin shkollë-shoqëri, në mes të institucioneve arsimore dhe shoqërisë përreth, me institucionet publike dhe private që merren me arsimimin dhe edukimin e fëmijëve tanë.
9. Bashkëpunon në planifikimin dhe vlerësimin e nevojave arsimore të Komunës së Vitisë, regjional, dhe Republikan.
10. Shqyrton propozimet dhe inicion planet lokale arsimore.
11. Mbështetje rreth trajnimeve profesionale të mësimdhënësve.
12. Shërbimet psiko-sociale në shkolla, për trajtime të rasteve të veçanta.
13. Kujdesi ndaj personave me aftësi të kufizuara, për angazhimin në procesin edukativo-arsimor në komunën e Vitisë.
14. Respektimi dhe promovimi i ligjshmërisë dhe transparencës.
15. Identifikimi dhe mundësia e stimulimit të nxënësve talent.
16. Mbështet bashkëpunimin shkollë-prindër, bashkëpunimin në mes të shkollave dhe komunitetit.
17. Kujdeset për mjedis të sigurt dhe miqësor në shkollat e komunës së Vitisë.
18. Aktivitete rreth rëndësisë së shkollimit dhe nxënies së dijes.
19. Përfshirja e të gjithë fëmijëve në edukimin parashkollorë.
20. Teknologjia arsimore dhe mjetet mësimore.
21. Analiza e rrezikut në shkollat tona.
22. Realizim i vizitave studimore në shkolla të nivelit lokal, por edhe shkollat në nivel kombëtarë.
23. Analiza e rezultateve të nxënësve, mundësia e mbështetjes në projekte.
24. Të ofrojmë një bashkëpunim që nxënësit tanë të kenë një mësim bashkëkohor me rezultate konkrete në fusha të caktuara.
25. Angazhimi për një digjitalizim të të gjitha shkollave.
26. Rezultatet e arritura për një vit shkollorë, arritja e qëllimeve.
27. Monitorimi i gjendjes së pastërtisë nëpër shkolla.
28. Përcjellja dhe kujdesi ndaj shëndetit të nxënësve.
29. Promovimi i kreativitetit dhe inovacionit, duke përfshirë edhe ndërmarrësin për arsimin profesional.
30. Vlerësimi i projekteve për shkolla të ndryshme.
31. Aktivitete rreth informimit për gjeneratat e reja, në frekuentimin e bibliotekës së qytetit.

32. Shqyrtimi i formimit të ekipeve të ekspertëve në nivel komunal.
33. Ligjëratë informuese për maturantët. Rëndësia e vazhdimit të shkollimit në Universitetet Publike, përparësitë, drejtimet dhe orientimi për çasje më të lehtë.
34. Vlerësimet e trajnimeve për mësimdhënës me karakter profesional.
35. Gjendja reale e zbatimit të trajnimeve profesionale në mësimdhënie.
36. Mundësia e organizimit të garave të diturisë në nivel komunal me ndikim Republikan.

### **KULTURA, RINIA DHE SPORTI**

1. Ndhmon drejtorinë e DKRS në hartimin e rregulloreve komunale, në pajtim me ligjet në fuqi për kulturë, rini dhe sport.
2. Përcjellja e aktiviteteve për ditën e Pavarësisë 17 Shkurt, Flakadanin e Karadakut dhe aktiviteteve të tjera kulturore në nivel të komunës së Vitisë.
3. Mbështet bashkëpunimin kulturë-shoqëri në mes të institucioneve kulturore dhe shoqërisë përreth, me institucionet publike dhe private që merren me arsimim dhe kulturë.
4. Përcjellja e ndarjes së çmimeve për laureatët sportiv për vitin 2022.
5. Takime konsultative për realizimin e plan programit vjetor për aktivitetet sportive të komunës së Vitisë.
6. Bashkëpunimi me OJQ-të, në kuadër të fushës së kulturës, rinisë dhe sportit.
7. Ndhmon në planifikimin dhe vlerësimin e nevojave që lidhen me kulturën ,rinin dhe sportin.
8. Ideja për plotësimin me materiale i hapësirave rinore në shkolla duke i dhënë shtysë kreativitetit dhe zhvillimit të aftësive për të rinjë.
9. Shqyrton propozimet dhe inicion planet lokale kulturore, rinore sportive.
10. Propozon programet dhe projektet për autoritetet lokale dhe ndërkombëtare, të njohura ndërkombëtarisht dhe propozon masat e nevojshme për realizimin e programeve kulturore ,rinore dhe sportive.
11. Takime konsultative me shoqëritë kulturore artistike që operojnë në komunën e Vitisë
12. Shqyrton programet dhe projektet të cilat subvencionohen nga Komuna dhe propozon mbështetjen e tyre eventuale.
13. Pjesëmarrja nëpër aktivitetet sportive, për të i parë nga afër organizimet e tyre.
14. Përcjellë zhvillimet ndërkombëtare që bëhen në lëmin e kulturës, rinisë dhe sportit që janë me interes për komunën.
15. Realizimi i takimeve mbi *best practice* dhe modelet me të mira ose fushatat me të mira të ndërmarra dhe sukseset e arritura duke analizuar format e organizimit dhe aksionet e ndërmarra.
16. Përkujdeset që trashëgimisë kulturore dhe historike të qytetit ti kushtohet rendësi e veçantë.
17. Organizimi i ecjeve në natyrë me qëllim, sensibilizimi për ruajtjen e mjedisit dhe ambientit.
18. Analiza rreth financimit të shoqërive kulturore që operojnë në komunën e Vitisë
19. Shqyrton prioritetet e programeve komunale në sferën e kulturës, rinisë dhe sportit.
20. Shqyrton programet komunale për investime kapitale në kulturë, rini dhe sport, në mënyrë që tu ofrojë institucioneve kushtet e nevojshme.

21. Bashkëpunimi me aktorët lokal si hotele, restorante, agjenci turistike, prodhues produktesh tradicionale dhe agroushqimore.
22. Takimet e përbashkëta me diasporën, rreth organizimit për ditët e diasporës.
23. Përcjellja e lojërave të futbollit për klubet FC. Vitia dhe FC.Vllaznia.
24. Diskutime me artistët vitias për projekte të ndryshme në kulturë me mundësi aktiviteti për skena teatrale, ofrimi i kushteve për talent të ri.
25. Takime me organizatat rinore, për aktivitetet e tyre.
26. Pjesëmarrje nëpër orët letrare, duke përcjell nga afër punimet
27. Kontakte me shoqatat e grave për angazhimin e tyre rreth aktiviteteve kulturore në komunën e Vitisë.
28. Fushata ndërgjegjësimi në kujdesin shëndetësor, seksual dhe droga. Realizimi i fushatave ndërgjegjësuere dhe edukuese të shëndetit parësor në bashkëpunim me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.
29. Ofrimi i bashkëpunimit me Shoqatën e Pedagogëve të Kulturës Fizike në komunën e Vitisë.
30. Organizimi i tryezave të përbashkëta me drejtorinë e DKRS-së.
31. Organizimi i vizitave nëpër vendet kulturore në komunën e Vitisë (shkolla e parë shqipe).
32. Diskutime me grupet kulturore dhe artistike.
33. Identifikimi i nevojave më urgjente në ambientet sportive shkollore dhe restaurimi i tyre duke i kthyer në funksionalitet të plotë.
34. Përcjellja nga afër e aktiviteteve të artistëve të artit pamor.
35. Vizitë klubeve të ndryshme sportive si: Futboll-it, Basketboll-it, arteve marciale Taekwondo&Hapkido etj.
36. Angazhimi rinor në nismat për mbrojtjen e mjedisit, dhe fushatat e ndërgjegjësimit mjedisorë.
37. Pjesëmarrës nëpër takime pune për kulturë, rini dhe sport.
38. Vizitë në panairin kulturor që mbahet në komunën e Vitisë dhe përcjellja nga afër.
39. Vizitë muzeut të qytetit dhe zyrës së arkivit.
40. Fushat bamirësie dhe përkrahjeje sociale.
41. Bashkëpunim i vazhdueshëm me organizata rinore.
42. Monitorimi i garave sportive.

Në saje të detyrave të përshkruara më lartë është hartuar plani i punës për këtë komitet, për vitin 2022, por duke pas parasysh se kemi të bëjmë me një fushë të gjerë dhe rëndësishme jemi munduar që t'i përshkruajmë disa nga detyrat e këtij komiteti, duke shpresuar se çdo herë të mund të korrigjohemi dhe të plotësojmë me të dhëna të tjera në interes të qytetarëve të komunës së Vitisë.

## Plani i punës i Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport për vitin 2022

Muaji	Pikat e rendit të ditës të propozuara:	Vendi i mbajtjes së mbledhjeve
Janar  Shkurt	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Raporti i DKA-së në lidhje me rezultatin e nxënësve (periudha e parë).</li> <li>2. Përgatitja për fillimin e periudhës së dytë shkollore.</li> <li>3. Siguria e nxënësve në trafik, për shkak të kushteve dimërore.</li> <li>4. Rregulloret e brendshme të shkollave.</li> <li>5. Përgatitja rreth aktiviteteve për ditën e Pavarësisë së Republikës së Kosovës 17 Shkurt.</li> <li>6. Të ndryshme.</li> </ol>	Zyra e Administratës
Mars  Prill	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Raporti në lidhje me PZHAK dhe nevojat e shkollave në bazë të këtij plani.</li> <li>2. Aktivitetet rreth organizimit të Flakadanit të Karadakut.</li> <li>3. Propozime për formën organizimit të ekskursioneve të nxënësve në nivel komunal.</li> <li>4. Planifikim dhe vizita nëpër shkolla për t'u njohur nga afër me nevojat dhe kërkesat e shkollave.</li> <li>5. Bashkëpunimi me Këshillin e Prindërve.</li> <li>6. Raporti i DKA-së në lidhje me rezultatin e nxënësve (periudha e dytë).</li> <li>7. Vizita të klubeve sportive dhe OJQ-ve rinore.</li> <li>8. Të ndryshme.</li> </ol>	Zyra e Administratës




<p>Maj</p> <p>Qershor</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Aktivitetet rreth organizimit të ditës së 5 Majit, ditës së dëshmorëve për komunën e Vitisë.</li> <li>2. Vlerësimi i ndarjes së bursave studentore.</li> <li>3. Përmbyllja e përfundimtare e procesit edukativo-arsimor për një vit shkollor.</li> <li>4. Mundësia e rishikimit të rregullores për nxënës nëpër shkolla.</li> <li>5. Procesi i mbajtjes së testeve të arritshmërisë, dhe testit kombëtarë.</li> <li>6. Aktivitetet për ditën e çlirimit të komunës së Vitisë, 14 Qershori.</li> <li>7. Të ndryshme.</li> </ol>	<p>Zyra e Administratës</p>
<p>Korrik</p> <p>Gusht</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Monitorimi i fillimit të regjistrimit për nxënës të klasëve të X-ta.</li> <li>2. Bashkërendim dhe koordinim me DKRS-në për organizimin e ditëve të diasporës.</li> <li>3. Vizitë shkollës së parë shqipe “Don Mikel Tarabulluzi” në Stubëll.</li> <li>4. Të ndryshme</li> </ol>	<p>Zyra e Administratës</p>
<p>Shtator</p> <p>Tetor</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Fillimi i vitit të ri shkollor, sfidat dhe përgatitja e kushteve nëpër shkolla.</li> <li>2. Cilësia e ushqimit në çerdhen “Gëzimi Ynë” dhe kuzhinën e shkollës fillore “Dëshmorët e Vitisë”.</li> <li>3. Vizitat mjekësore sistematike nga ekipet mjekësore nëpër shkollat e Vitisë.</li> <li>4. Raporti mbi furnizimin e nxënësve me librat për vitin e ri shkollor</li> <li>5. Parapërgatitja e shkollave për sezonin dimërore.</li> <li>6. Furnizimi i shkollave me ujë të pijes dhe cilësia e ujit nëpër shkolla.</li> <li>7. Të ndryshme.</li> </ol>	<p>Zyra e Administratës</p>

Nëntor	1. Aktivitetet për ditën e shqiptarëve 28 Nëntori, shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë.	
Dhjetor	<ol style="list-style-type: none"> <li>2. Përfundimi i periudhës së parë në të gjitha shkollat e komunës së Vitisë.</li> <li>3. Kushtet e punës së zhvillimit normal të mësim-nxënies dhe mësim-dhënies në stinën e dimrit.</li> <li>4. Përmbledhje e punës një vjeçare të komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport.</li> <li>5. Mundësia e ndryshimit dhe përgatitjes së planit të punës së këtij komiteti për vitin e ardhshëm 2023.</li> <li>6. Të ndryshme.</li> </ol>	Zyra e Administratës

Kryesuesi i komitetit për Arsim  
Kulturë, Rini dhe Sport  
Msc. Mujli Neziri





Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika h të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr. 03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare nr.28/2008), neni 50 paragrafi 1 shkronja I. të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr.013/491 të datës 21.04.2011, dhe kërkesa e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastruktura me Nr. 1987-2/22 e datës: 15.04.2022, Kryetari i Komunës së Vitisë paraqet këtë

### PROPOZIM VENDIM

Për shfuqizimin e vendimit për caktimin e lokacionit për varrezat e fshatit Kabash me Nr. 01-110/05-365, të datës 04.04.2022

#### Neni 1.

Me këtë propozim – vendim i propozohet Kuvendit të komunës së Vitisë që të shfuqizoj vendimin për caktimin e lokacionit për varrezat e fshatit Kabash me nr.01-110/05-365, të datës 04.04.2022.

#### Neni 2.

Me këtë propozim- vendim, i propozohet Kuvendit të komunës së Vitisë që të shfuqizoj vendimin për caktimin e lokacionit për varrezat e fshatit Kabash me nr.01-110/05-365, të datës 04.04.2022 me kërkesen e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë me Nr. 1987-2/22 e datës: 15.04.2022.

#### Neni 3

Për zbatimin e këtij propozim-vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës së Vitisë, Drejtorja për Shërbime Publike dhe Emergjencë dhe drejtorit tjera të komunës së Vitisë, do të kryejn veprimet e tyre nga përgjegjësit e tyre të caktuara për relazimin e këtij propozim vendimi.

#### Neni 4


Ky Propozim-Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në wep e Komunës.





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Prilajena M/Opno 16-05-2022			
Nr. i organit Org. broj	Kutari/Çroj	Shtetëse Prilog	Vlera Vrednues
01-016/01-525			



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality of Viti/na

**Nga: Kryesuesi i Kuvendit Komunalë të Vitisë  
Për Kuvendin Komunal**

**Lënda: Informatë mbi punën e komiteteve funksionale për periudhën janar-maj 2022**

Të nderuar këshilltar të Kuvendit Komunalë të Vitisë! Më lejoni që konform planit të punës të kuvendit komunal të Vitisë për vitin 2022 që para juve ta paraqes informatën mbi punën e komiteteve funksionale që janë të themeluar nga Kuvendi Komunal i Vitisë.

Kuvendi Komunal i Vitisë, duke u bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, dhe me Statutin e Komunës së Vitisë, ka të themeluar komitete obligative dhe komitetet joobligative.

Komiteti për Politik dhe Financa është komitet obligativ, i cili si çdo vit edhe në këtë vit është shumë aktiv, i cili për këtë periudhe kohore ka mbajtur katër mbledhje.

Komiteti për Komunitete gjithë ashtu është komitet obligativ, i cili për këtë periudhe kohore ka mbajtur katër mbledhje.

Përveç këtyre komiteteve kuvendi komunal i Vitisë ka të themeluar edhe komitete të tjera si:

1. Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqene Sociale (i cili komitet e ka mbajtur mbledhjen e parë).
2. Komiteti për Shërbime Publike (i cili komitet e ka mbajtur mbledhjen e parë)
3. Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport (i cili komitet i ka mbajtur dy mbledhje)
4. Komiteti për Liritë, të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore (i cili komitet e ka mbajtur mbledhjen e parë)
5. Komiteti për Planifikim, Rregullim të Hapësirave dhe Mirëmbajtjen të Mjedisit (i cili komitet e ka mbajtur mbledhjen e parë)

Pothuajse të gjitha komitetet e cekura me lartë, joobligative kanë qenë aktive.

Me lejoni të ju njoftoj që Kuvendit Komunal ka mbajtur deri me tani katër mbledhje të rregullta e tri solemne. Nga mbledhjet e rregullta kemi miratuar 32 vendimet dhe një ndryshim plotësim të rregullore.

**Kryesuesi i Kuvendit  
Bekim Azizi**

